



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA**

**ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM**  
**KANCELARIJA GENERALNOG REVIZORA / OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL**

---

# **Raporti Vjetor i Performancës**

# **2010**

---

Prishtinë, April 2011

### ADRESIMI I AUDITORIT GJENERAL

I nderuar z. Kryetar, të nderuar anëtarë të Kuvendit të Republikës së Kosovës



Dëshiroj të filloj me urimin tim për Legjislaturën e re të themeluar. Pres me kënaqësi një bashkëpunim konstruktiv të mëtjetshëm.

Ky është Raporti i tretë Vjetor i Performancës nga Auditori i Përgjithshëm. Ky raport përqendrohet në mënyrën se si Auditori i Përgjithshëm i ka shfrytëzuar burimet dhe përmbledh rezultatet e arritura gjatë vitit 2010. Gjithashtu, ky raport mundëson krahasimin me dy vitet e mëparshme buxhetore.

Raporti Vjetor i Performancës është një përgjigje e rëndësishme drejtuar Kuvendit të Kosovës tek i cili Auditori i Përgjithshëm raporton rreth ushtrimit të mandatit për vitin 2010. Në të njëjtën kohë, raporti shërben si një kontribut në dialogun për buxhetin mes Kuvendit dhe Auditorit të Përgjithshëm për vitin buxhetor 2012.

Viti 2010, ishte një vit kur qasjet tona të reja filluan të bëheshin të dukshme kudo në administratë. Mbulimi i auditimit dhe ndikimi i punës tonë po zhvillohet. Linjat e llogaridhënies mes Kuvendit dhe Zyrës janë përforcuar që me themelimin dhe funksionimin e Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike.

Një numër i konsiderueshëm i raporteve tona është analizuar në këtë komision dhe në të njëjtën kohë forma e menaxhimit të një numri të përgjegjësve është vëre në pyetje.

Këto ndryshime janë inkurajuese. Në të njëjtën kohë, ato krijojnë sfida të reja për mua dhe Zyrën në trajtimin e pritshmërive. Por, këto ndryshime krijojnë edhe shanse të reja për Zyrën dhe palët e saj të interesit, Legjislativin dhe Ekzekutivin. Ato gjithashtu krijojnë mundësi për qasje të re në lidhje me median dhe publikun e gjerë. Unë do të mundohem ti përdor këto mundësi për të zhvilluar më tutje arena dhe metoda që nxisin transparencën dhe llogaridhënien.

Pavarësia është një parakusht për një auditim të jashtëm publik që funksionon mirë. Legjislacioni i ri në fushën e shërbyesit civil, si dhe situata jo shumë e qartë ligjore si një organ ku nuk bëhen ndërhyrje në procesin e buxhetit janë shqetësuese për mua. Po aq shqetësuese është ndryshimi mes pritshmërive dhe burimeve të dhëna. Këtyre çështjeve do ti kthehem më vonë kur të adresojmë kornizën tonë ligjore.

Vizioni dhe strategjia jonë janë që të bëhemi një institucion publik i auditimit të jashtëm i cili vepron në pajtim të plotë me standardet e pranuar ndërkombëtarisht dhe praktikën e mirë Evropiane. Ky raport tregon që ne kemi bërë hapa të rëndësishëm në këtë rrugëtim pa fund. Në të njëjtën kohë, ne jemi plotësisht të vetëdijshëm që varem në bashkëpunimin dobiprurës dhe në një dialog të mirë për buxhetin me palët tona kryesore të interesit për të përmbushur ambiciet tona të larta dhe qëllimin tonë të përbashkët - një sektor publik më të mirë dhe më llogaridhënës në Kosovë.

Unë shpresoj se ky raport do të kontribuojë në përforcimin e kësaj.

Prishtinë, 30 prill 2011

Auditor i Përgjithshëm

### PËRMBLEDHJE E PERFORMANCËS

Viti buxhetor 2010 tashmë ka përfunduar dhe këtu paraqitet Raporti jonë Vjetor i Performancës sipas detyrave tona të parashikuara me ligj.

Gjatë vitit 2010, ne ngritëm në mënyrë të dukshme numrin e auditimeve të kryera si dhe përmirësuar cilësinë e raporteve në pajtim me praktikën e mirë moderne. Kemi zhvilluar një dialog konstruktiv me palët tona të interesit – Kuvendin, Qeverinë, institucionet e audituara, dhe në veçanti Ministrinë e Financave – dhe do të vazhdojmë t'i thellojmë këto marrëdhënie. Stafi ynë është trajnuar dhe motivuar më shumë se kurrë më parë dhe janë të etur për t'u zhvilluar në bazë të suksesit të kohëve të fundit.

#### Pikat kryesore

*Sezoni i auditimit 2009/10 përfundoi në gusht 2010. Gjithsej kryem dhe raportuam mbi 70 auditime të ndryshme. Më detajisht ne kryem:*

- 63 Auditime të rregullsisë në kuadër të Buxhetit të Kosovës;
- Dy Auditime të rregullsisë të ndërmarrjeve publike: Kompania rajonale e ujërave “Prishtina” dhe Kompania rajonale e mbeturinave “Pastrimi”;
- Dy auditime të menaxhimit financiar: Auditimi mbi menaxhimin në “Termokos” dhe në Radio Televizionin e Kosovës;
- Një Auditim të performancës në lidhje me funksionimin e procesit të certifikimit;
- Një projekt ndërkombëtar në lidhje me trajnimin profesional;
- Përgjithësuam këto raporte plus auditimin e veçantë të Buxhetit të Kosovës, në nivelin qendror, në Raportin Vjetor të Auditimit, të cilin ia dorëzuam Kuvendit në kohë. Ky raport ishte në të gjitha aspektet relevant, konsistent, dhe i kuptueshëm; dhe
- Punuam ngushtë me Komisionin për mbikëqyrje të financave publike (KMFP), në kuadër të Kuvendit, detyra e të cilit është që të rishikojë raportet tona, dhe nëse është e nevojshme të veprojë në bazë të tyre. Si rezultat, janë mbajtur një numër dëgjimesh dhe konferencash për shtyp ku shpenzuesit buxhetor janë vënë para përgjegjësisë.

*Sezoni i auditimit 2009/10 filloi në shtator 2010. Gjatë vitit 2010 ne:*

- Filluam me gati 80 auditime të rregullsisë, katër auditime mbi menaxhimin, dhe tre auditime të performancës. Raporti jonë Vjetor i Auditimit për vitin 2010 do të bazohet mbi gati 90 auditime në krahasim me rreth 70 të vitit të kaluar;
- Zvogëluam numrin e auditimeve të komunave të kontraktuara jashtë, nga 29 në 23 dhe përfshimë auditimin e ndërmjetëm për të gjitha komunat;
- Filluam të auditojmë shpenzimet që bëhen jashtë Kosovës përmes auditimeve të ambasadave kosovare në Bruksel dhe Paris (si pjesë e auditimit tonë në Ministrinë e Punëve të Jashtme);

## Raporti Vjetor i Performancës

- Përfshimë auditimin e ndërmjetëm në të gjitha auditimet tona me qëllim që të jemi më parandalues dhe të sigurohemi që rekomandimet tona adresohen ashtu si duhet;
- Përfshimë 34 Verifikime të veçanta vjetore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin në ato institucione buxhetore të vogla, ku ne nuk kemi burimet që të kryejmë një auditim të plotë vjetor, duke u siguruar që të gjithë shpenzuesit vizitohen çdo sezon auditimi;
- Përfshimë rishikime të veçanta analitike të draft PVF-të dhe krijuam një lloj regjimi për të diskutuar konkluzionet tona me Ministrinë e Financave, duke synuar zvogëlimin e rrezikut për gabime të qëllimshme ose të paqëllimshme; dhe
- Zhvilluam më tej qasjen tonë parandaluese për auditim duke bashkëpunuar ngushtë me Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike si dhe duke punuar në kuadër të strukturave përgjegjëse për zhvillimin, zbatimin, dhe monitorimin e qeverisjes së mirë; veçanërisht me strukturat për Menaxhimin e Financave Publike dhe Kontrollin si dhe Auditimin e Brendshëm.

Gjatë vitit buxhetor ne i dhamë këshilla të shumta ministrive dhe shpenzuesve të tjerë buxhetor në lidhje me menaxhimin e financave publike dhe çështjet e ndërlidhura me të. Ne kemi kontribuar në zhvillimin e qeverisjes së mirë.

Ne vazhduam partneritetin me projektin e binjakëzimit me Zyrat e Auditimit të Mbretërisë së Bashkuar, Sllovenisë, dhe Holandës. Këta partnerë na ndihmuan që t'i zhvillojmë funksionet tona duke zbatuar standardet e auditimit të pranuar ndërkombëtarisht dhe praktikën e mirë evropiane.

Kemi forcuar kapacitetet tona në një numër aspektesh duke e kryer mandatin tonë në një mënyrë efektive. Kemi futur në përdorim mjete të ndryshme menaxhimi dhe administrative. Kompletimi i këtyre mjeteve ka filluar por ende jemi në fazat fillestare.

Raporti Vjetor i Performancës u dorëzua në kohë. Ai është një instrument i nevojshëm përmes të cilit Auditori i Përgjithshëm jep llogari për rezultatet e arritura, si dhe jep detaje se si ZAP e ka zbatuar buxhetin e vet.

Vlerësimet nga BE në Raportin e Progresit ishin se ne jemi në rrugën e duhur të zhvillimit dhe në të njëjtën kohë u shprehën shqetësimet në lidhje me pavarësinë tonë.

### **Fokusi i ardhshëm**

Ne kemi formuar disa nga prioritetet tona. Për t'i arritur ato, kemi përshtatur procesin tonë të auditimit për të përfshirë objektivat kryesore të INTOSAI-it siç janë: sigurimi i përdorimit të duhur dhe të dobishëm të fondeve publike; zhvillimi i një menaxhimi të shëndoshë financiar; zbatimi i legjislacionit në fushat e ekonomisë dhe financave; dhe komunikimi e ofrimi i informacionit tek autoritetet publike dhe opinionin publik duke publikuar raporte të paanshme.

Objektivat dhe fokusi jonë për vitin që vjen do të jenë:

1. Ndryshimi i kornizës në një kontekst më të gjerë (ndërhyrjet janë shtyrë për shkak të gjendjes politike në kohët e fundit);

2. Themelimi dhe vënia në funksion e një skeme të re për certifikim profesional;
3. Numri i auditorëve të certifikuar do të jetë 25 më shumë nga ai aktual. Auditorët do të kalojnë fazën tjetër në skemën e certifikimit;
4. Ngritja e lehtë e numrit të auditimeve të kryera në krahasim me sezonin aktual. Ne do të kryejmë më shumë auditime të komunave me stafin tonë. Intensiteti i auditimit në disa sektorë më të mëdhenj do të forcohet;
5. Zhvillimi i auditimit të fondeve nga donatorët bazuar në një tarifë, duke hapur kështu rrugën për marrëdhënie të reja financiare mes Kosovës dhe komunitetit të donatorëve;
6. Adresimi i fushave të reja të auditimit dhe një qasje më e fokusuar mbi sistemin e prokurimit;
7. Vënia e manualeve dhe udhëzuesve plotësisht në përdorim;
8. Dorëzimi i RVA-së dhe APR-së në kohë dhe me cilësi të mjaftueshme, mbulim më të lartë auditimi; relevant dhe i kuptueshëm;
9. Qasje, forma, dhe masa të reja me synimin për të zhvilluar qeverisjen e mirë të theksuar;
10. Implementimi i një kulture të orientuar nga performanca, ku ne i përmbushim objektivat tona operative dhe administrative përmes të punësuarve profesionistë dhe të motivuar në të gjitha nivelet;
11. Përdorimi i mjeteve më të mira menaxheriale dhe administrative (për shembull një sistem për regjistrimin e kohës); dhe
12. Promovimi i mëtejshëm i të kuptuarit të objektivave, operimeve, dhe aktiviteteve për rezultate nga palët tona të interesit, përfshirë edhe shoqërinë civile.

Ne jemi të dedikuar që jo vetëm të ofrojmë informacion cilësor mbi përdorimin e fondeve publike, por edhe të ndihmojmë entitetet e audituara që të përmirësojnë sistemet e tyre të kontrollit – duke i shtuar vlerën punëve të tyre.

Ne jemi të dedikuar që të ndihmojmë në ndërtimin e qeverisjes së mirë në administratën publike të Kosovës dhe ti përgjigjemi pritshmërive.

### 1. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

#### **Kush jemi ne?**

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është institucion kushtetues i pavarur dhe i raporton drejtpërdrejtë Kuvendit. ZAP udhëhiqet nga Auditori i Përgjithshëm mandati dhe detyrat e të cilit janë të përcaktuara me Kushtetutën dhe me Ligjin për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës dhe Zyrës së Auditimit në Kosovë 03/L-075. Deri në përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare, Auditori i Përgjithshëm do të jetë i emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (PCN).

Auditori i Përgjithshëm aktual u emërua në fillim të vitit 2009 dhe do të ushtrojë funksionin e tij në pajtim me rregulloret në fuqi. Auditori i Përgjithshëm, në ushtrimin dhe përmbushjen e detyrimeve të tij për arritjen e objektivave, gëzon liri të plotë të ndërmarrë aksionet e duhura në funksion të kompetencave të tij. Ai përgjigjet vetëm para Kuvendit.

Ruajtja e objektivitetit dhe pavarësisë tonë nga organizatat të cilat i auditojmë është vendimtare. Objektiviteti dhe pavarësia duhet të sigurohen me zbatimin e mirë të një mandati të gjerë, të qëndrueshëm, dhe ligjor; pajtueshmërinë me standardet profesionale të auditimit; dhe kodin e mirësjelljes profesionale.

#### **Çfarë do të bëjmë?**

Ne do të kryejmë Auditimet e Rregullsisë të Buxhetit të Kosovës, organizatave buxhetore në bazë vjetore, duke përfshirë këtu edhe Kuvendin, Zyrën e Presidentit, çdo ministri dhe agjenci ekzekutive, komunat, organet e pavarura dhe entitete të tjera.

Ne gjithashtu do të kryejmë Auditime të Performancës. Kjo është në fushëveprimin tonë, por nuk është një kërkesë vjetore e parashikuar me ligj. Këto auditime do të kryhen në mënyrë që të vlerësojmë nëse programet qeveritare janë duke u menaxhuar si duhet, ekonomikisht, dhe në mënyrë efikase, dhe nëse janë vendosur masa për matjen dhe raportimin e efikasitetit të tyre.

Ne do të raportojmë për auditimet tona tek entitetet e audituara dhe Kuvendi (KMFP) dhe këto raporte do të publikohen. Raportet tona do të përmbajnë rekomandime ku do të adresohen mangësitë më serioze të identifikuara. Me këtë duam t'i ofrojmë një shërbim auditimi profesional e të integruar Kuvendit, Qeverisë, dhe Taksapaguesve.

Me qëllim të ndihmojmë në zbatimin, zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e Menaxhimit të Financave Publike, ne do të sigurojmë tatimpaguesit dhe donatorët ndërkombëtar se burimet publike përdoren në mënyrë ekonomike, efektive dhe efikase dhe t'i shtojmë vlerë proceseve përkatëse zhvillimore. Ne do ta bëjmë këtë duke siguruar se fondet publike raportohen, administrohen dhe përdoren në mënyrën e duhur dhe me maturi.

#### **Si do ta dëshmojmë përgjegjshmërinë?**

Pasqyrat tona Vjetore Financiare (PVF) përgatiten sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Ato janë në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik mbi Bazat e Parasë së Gatshme dhe modifikimet e aplikueshme sipas vendimit

të Qeverisë. Për të na mundësuar të dëshmojmë përgjegjshmërinë dhe objektivitetin tonë, Kuvendi çdo vit duhet të emërojë një auditor të jashtëm për të bërë auditimin e Pasqyrave tona Vjetore Financiare.

Opinionet e auditimit mbi PVF-të e viteve 2008 dhe 2009 nuk u përfshinë në Raportin Vjetor të Performancës të vitit të kaluar. Këto auditime u raportuan në Kuvend në Shtator 2010. Për të dy vitet u dhanë opinione të pa kualifikuara ('i pastër'). Raportet janë publikuar në faqen zyrtare të internetit të ZAP-it.

Sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, në mars të vitit 2010 është emëruar një Auditor i Brendshëm për të audituar praktikën tona menaxhuese dhe administrative dhe për tu siguruar se Zyra vepron në pajtueshmëri me ligjet dhe politikën e veta.

### **Kush do t'i vlerësojë metodologjinë tonë të auditimit?**

ZAP ka bërë shumë për të siguruar që të ndiqen praktikën dhe metodologjinë e mira të auditimit. Ne jemi duke zbatuar një kornizë të menaxhimit të cilësisë. Metodologjinë e mira dhe kornizën e cilësisë sigurojnë që auditimet tona kryhen në pajtim me standardet<sup>1</sup> e themeluara të praktikës profesionale.

ZAP ndjek sistemin e rregullt ndërkombëtar të kontrolleve mbi punën e saj të auditimit; auditimet tona ekzistojnë në kuadër të një kornize rigoroze të standardeve të auditimit, të cilin stafi mëson se si ta përdorë gjatë programit tonë të trajnimit. Pastaj, gjatë një procesi qartësi, bihet dakord me entitetet e audituara për të gjeturat e auditimit. Në sistemin tonë është ndërtuar rishikimi nga ana e menaxhmentit dhe monitorimi i mëtejshëm bëhet nga një funksion i veçantë në kuadër të Zyrës. Pas kësaj, raportet tona publikohen dhe janë të hapura për ekzaminim. Pastaj fillojnë shqyrtimet dhe diskutimet në Kuvend së bashku me Ekzekutivin rreth rekomandimeve të auditimit.

Tashmë në pranverë kolegët tanë nga Zyra Kombëtare e Auditimit e Suedisë në bashkëpunim me USAID do të bëjnë një vlerësim të cilësisë së punës që kemi kryer.

### **Kush do të rishikojë financimin tonë?**

Si Auditor i Përgjithshëm, unë – përveç këtij Raporti Vjetor të Performancës që fokusohet në mënyrën se si është shpenzuar buxheti i Zyrës së Auditimit – do të përgatis dhe dorëzoj çdo vit në Kuvend kërkesat buxhetore. KMFP dhe Komisioni për Buxhet mund të më drejtohen mua për të shpjeguar kërkesën buxhetore për Zyrën dhe për të diskutuar raportin tonë mbi planet dhe prioritetet, objektivat e performancës, raportin tonë vjetor të performancës, dhe praktikën tona menaxhuese.

Qeveria e inkorporon kërkesën time buxhetore në Buxhetin e Kosovës të paraqitur në Kuvend ashtu siç është e propozuar nga Komisioni për Buxhet. Buxheti i Zyrës do të aprovohet nga Kuvendi. Praktikisht, proceset aktuale nuk janë të dizajnuara mirë dhe praktikën lejnjë vend për përmirësim.

---

1 SNISA, *Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit* përcaktojnë parakushtet themelore për funksionimin e duhur dhe sjelljen profesionale të institucioneve të tilla: [www.issai.org](http://www.issai.org)

### 2. TREGUESIT E REZULTATIT

Treguesit tonë të rezultatit kanë të bëjnë me sezonin e auditimit, i cili fillon në shtator dhe mbaron në gushtin tjetër. Treguesit që ne po përdorim tani janë a) numri i raporteve të përpiluara dhe raportuara; b) mbulimi i auditimit; c) opinionet e dhëna; d) respektimi i afateve të fundit kohore; e) cilësia; dhe f) ndikimi.

#### 2.1 Numri i raporteve

Në fund të sezonit të auditimit për vitin 2009/2010 ne raportuam në përgjithësi për 70 auditime:

- Raporti i BK-së;
- 63 Raporte të auditimit të rregullsisë në kuadër të BK-së;
- Dy auditime të rregullsisë për Ndërmarrjet Publike: Kompania rajonale e ujërave “Prishtina” dhe Kompania rajonale e mbeturinave “Pastrimi”;
- Dy auditime të menaxhimit financiar: auditimi i menaxhimit në Termokos dhe në Radio Televizionin e Kosovës (RTK);
- Një Auditim i Performancës në lidhje me funksionimin e procesit të certifikimit; dhe
- Një auditim i një projekti ndërkombëtar: Programi i qeverisë daneze “Promovimi i punësimit përmes zhvillimit të aftësive dhe biznesit”.

Tabela 1, tregon një ngritje të vazhdueshme të numrit të auditimeve të kryera në tre vitet e fundit. Numri i auditimeve të kontraktuara është zvogëluar, por jo edhe aq dukshëm. Arsyeja për këtë është kryesisht nevoja për të mbuluar të gjitha Komunat me auditim të detyrueshëm të rregullsisë ndonëse në të njëjtë kohë kapacitetet tona kanë qenë të kufizuara.

**Tabela 1: Auditimet e kryera dhe raportuara**

Entitetet e audituara	Sezoni i auditimit 2010/2011	Sezoni i auditimit 2009/2010	Sezoni i auditimit 2008/2009	Sezoni i auditimit 2007/2008 <sup>1</sup>
<i>Auditimi i rregullsisë</i>				
BK	1	1	1	1
Autoritetet shtetërore <sup>2</sup>	24	23	17	16
Komunat	33	33	33	29
(Të kontraktuara) <sup>3</sup>	(23)	(29)	(31) <sup>4</sup>	(19) <sup>5</sup>
Institucionet e pavarura	15	7	5	8
Jashtë BK-së	4	2	1	
Ndërkombëtare	1	1		
<i>Auditime të menaxhimit</i>	4	2		
<i>Auditime të performancës</i>	4	1		
<b>Totali</b>	<b>86</b>	<b>70</b>	<b>57</b>	<b>54</b>
<i>Verifikime<sup>6</sup></i>	34			

1 Në atë kohë, koncepti i auditimit nuk ishte i zhvilluar. Të gjitha këto auditime u kryen dhe raportuan me vonesë për sa i përket procesit buxhetor. Kur në këtë raport bëjmë krahasime të numrave të auditimeve të kryera, ne marrim parasysh numrin e raporteve të përpiluara në kohë.

2 18 Ministri, Zyra e Presidentit, Administrata e Kuvendit të Kosovës, Zyra e Kryeministrit, Administrata Tatimore, Dogana, dhe Universiteti i Prishtinës janë të përfshira.

3 Numri i auditimeve të komunave të kontraktuara tek firmat private të auditimit.

4 Këto auditime nuk janë kontraktuar në kohë për të lejuar që të përdoren në Raportin Vjetor të Auditimit.

5 Këto auditime nuk janë kontraktuar në kohë për të lejuar që të përdoren në Raportin Vjetor të Auditimit.

6 Tek Verifikimet (një rishikim analitik i fokusuar) ne analizuam gjendjen e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Të gjitha këto verifikime u raportuan gjatë vitit 2010.



Tabela 2 tregon auditimet e kryera, dhe ato që janë në proces, nga të kontraktuarit jashtë, duke përfshirë koston e këtyre auditimeve.

**Tabela 2: Auditimet e kontraktuara tek firmat private të auditimit**

	2010/11: në proces	2009/10	2008/09	2007/08
Numri i auditimeve	23	29	31	20 <sup>7</sup>
Numri i firmave të auditimit	3	3	2	2
Kosto	141,528	141,528	148,940	60,800

Numri i ulët i auditimeve të kryera në sezonin aktual në të njëjtin nivel të koston së sezonit të kaluar shpjegohet nga fakti se të kontraktuarit janë duke kryer punë shtesë në çdo detyrë individuale, auditim i ndërmjetëm.

## 2.2 Mbulimi i auditimit

*Sezoni i auditimit 2009/2010*

Auditimi ynë i rregullsisë është kryer gjatë viteve tek autoritetet nën BK deri në nivelin e paraqitur më poshtë:

**Tabela 3: Mbulimi i auditimit të KB (%)**

Mbulimi	2010	2009	2008
Shpenzimet	87	80	71
Të hyrat	99	95	86

*Gjatë sezonit të auditimit 2009/10* ne filluam të kryenim auditim të ndërmjetëm të Organizatave Buxhetore. Gjatë atij procesi të auditimit ne adresuam faktin se si janë trajtuar rekomandimet e dhëna më herët dhe cilësinë e menaxhimit financiar. U dhanë këshilla në 36 memo të auditimit në janar 2010.

*Gjatë sezonit të auditimit 2010/11* ne kryem auditim të ndërmjetëm në të gjitha organizatat buxhetore të mbuluara nga një auditim i plotë i rregullsisë, me përjashtim të dy prej tyre. Në dhjetor, u dorëzuan 74 memo të auditimit duke i dhënë entiteteve të audituara më shumë kohë për të marrë masa. Për herë të parë, ne kryem Verifikime të menaxhimit financiar në 34 organizata buxhetore që nuk i janë nënshtruar një auditimit të plotë. Në pesë raste, këto verifikime kanë çuar në auditime të plota.

7 Numri i paraqitur këtu është 20 dhe jo 19 siç tregohet në tabelën më sipër. Arsyeja për këtë është gjatë atij sezoni ne kontraktuam edhe auditimin e PVF-ve tona.



*Dorëzimi i PVF-ve në ZAP: Beza Halilaj, Lage Olofsson (ZAP) dhe Lulzim Ismajli dhe Nysret Koca (Thesar, MF)*

### 2.3 Opinionet e dhëna

Opinionet tona të auditimit bazohen në standarde të aplikueshme, të njohura si SNISA. Opinionet tona të auditimit për vitin 2009 ishin si në vijim:

- 16 opinione të pakualifikuara. Raporti i BK-së përfshihet në këtë grup;
- 16 opinione të pakualifikuara me theksim të çështjes;
- Katër opinione të kualifikuara;
- Dy opinione të kundërta;
- Për 29 komuna, auditorët nuk mundën të japin një opinion mbi pasqyrat financiare të marra si tërësi për shkak të paqartësisë apo kufizimit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të ishte adekuat, jepet mohim i opinionit; dhe
- Një Komunë ka refuzuar të prodhojë PVF dhe si pasojë ne nuk kemi mundur të kryejmë auditimin e asaj Komune.

Ne japim një opinion të pakualifikuar kur në të gjitha aspektet materiale ne kemi qenë të kënaqur që: a) Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur baza dhe politika të pranueshme të kontabilitetit të cilat janë aplikuar në mënyrë konsistente; (b) Pasqyrat janë në pajtim me kërkesat ligjore dhe rregulloret përkatëse; (c) Pikëpamja e prezantuar nga pasqyrat financiare është konsistente me njohuritë e Auditorit të entitetit të audituar; dhe (d) Ekziston një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale në lidhje me pasqyrat financiare.

Një Opinion i kualifikuar, apo akoma më keq një Opinion i kundërt, paraqet probleme serioze në raportimin financiar të buxhetit publik.

Në krahasim me sezonin e mëhershëm të auditimit, numri i opinioneve të kualifikuara është në zbritje. Kjo nuk mund të interpretohet si një shenjë e mirë e cilësisë së menaxhimit financiar dhe kontrollit.

### 2.4 Afatet kohore të raporteve tona

Detyrat individuale të auditimit të shpenzuesve buxhetor duhet të raportohen në fund të qershorit për vitin pas vitit buxhetor. Auditimet e Rregullsisë këtë vit i kemi kryer me kohë, sezoni i auditimit 2009/10, dhe u raportuan gjatë qershorit sipas planifikimit.

Raporti ynë gjithëpërfshirës Vjetor i Auditimit 2009 u përpilua në kohë dhe iu dorëzua Kuvendit në fund të gushtit 2010. Në të gjitha aspektet, raporti ishte relevant, konsistent, dhe i kuptueshëm.

Sfidë e jona kryesore është që të fokusojmë proceset tona të punës në atë mënyrë që ti finalizojmë auditimet në kohë, me cilësi të mjaftueshme, dhe në numër sa më të madh që është e mundur me burimet që i kemi.

### 2.5 Cilësia

Që nga fillimi i sezonit të auditimit 2009/10, korniza e cilësisë është integruar plotësisht në procesin e auditimit. Ne sigurojmë një punë më të mirë përmes cilësisë, e cila është pjesë integrale e procesit tonë të auditimit. Masat e marra për monitorimin e cilësisë së raporteve përpara finalizimit të tyre janë zhvilluar, por ende mbetet shumë për tu bërë përpara se Sistemi jonë për Menaxhimin e Cilësisë të stabilizohet në një nivel të mjaftueshëm.

Përmirësime thelbësore janë vërejtur në cilësinë e raporteve tona (qartësia, lexueshmëria, kuptueshmëria, dhe përputhshmëria me standardet ndërkombëtare të auditimit).

### 2.6 Ndikimi

Në vitet e mëparshme, entitetet e audituara kanë zbatuar në një përqindje më të vogël rekomandimet e dhëna. Kjo ka ndodhur pjesërisht për shkak të mënyrës se si i kemi formuluar rekomandimet tona – një mënyrë e cila nuk ishte në pajtim të plotë me standardet e njohura ndërkombëtarisht dhe praktikën e mirë. Në të njëjtën kohë, ne duhet të vërejmë se rekomandimet tona nganjëherë nuk janë trajtuar nga menaxhmenti i lartë i entiteteve të audituara, dhe kjo ka kontribuar gjithashtu në normën e ulët të ndërmarrjes së veprimeve mbi rekomandimet tona.

Futja në përdorim e auditimit të ndërmjetëm në të gjitha detyrat individuale ka kontribuar në një ndikim më të mirë. Gjatë këtij procesi të auditimit, ne përcjellim procesin e adresimit të rekomandimeve tona të mëparshme dhe cilësinë e menaxhimit financiar. Ne gjithashtu i japim rekomandime të mëtejshme menaxhmentit të entiteteve të audituara, dhe këtu përfshihen rekomandimet mbi pasqyrat financiare. Futja në përdorim e Verifikimeve në MF/K, është në vetvete një masë parandaluese pasi të gjitha organizatat buxhetore janë në dijeni për 'gjendjen' e tyre aktuale. Kjo gjithashtu hap rrugën për një dialog më të mirë dhe interaktiv me klientët dhe auditorët e jashtëm.

Gjatë 2009/10 ne ndryshuam qasjen e raportimit. Kjo qasje e ripunuar do të sigurojë që menaxherët e entiteteve të audituara të mund të shikojnë më qartë dobësitë e identifikuara në punën tonë të auditimit. Ne i caktuam këto rekomandime si objektiva ndaj menaxherëve përkatës brenda entiteteve të audituara. Kjo qasje duhet të na çojë drejt një partneriteti më produktiv mes nesh dhe klientëve tanë dhe duhet të gjithashtu të bëjë që rekomandimet tona të kenë ndikim më të madh.

Tashmë ne shohim që entitetet e audituara po prodhojnë plane veprimi më rigorozë si përgjigje ndaj rekomandimeve tona. Tani i takon të dy palëve, ZAP-it dhe entiteteve të audituara, që të aplikojnë këtë proces në mënyrë që të fitojmë ndryshim real dhe të gjatë.

Ka raste kur menaxhmenti i entiteteve të audituara vazhdimisht nuk performojnë mirë. Për këtë ne kemi punuar me Kuvendin dhe diskutuam me ta se sa e rëndësishme është që njerëzit të vihen para përgjegjësisë.

Gjatë vitit 2010, KMFP i ka rishikuar të gjitha raportet tona të publikuara. Dhjetë raporte të auditimit të rregullsisë dhe një raport i performancës janë adresuar në seanca dëgjimore ku kanë qenë prezent përfaqësues të entiteteve të audituara.

Ne do ta monitorojmë me kujdes këtë situatë dhe zhvillimin e saj për të nxitur një kulturë më të mirë të llogaridhënies në sektorin publik.

### 3. BURIMET

#### 3.1 Buxheti

Buxheti fillestar i aprovuar për ZAP-in për vitin 2010 ishte €1,358,943. Ky ishte më i lartë se ai i vitit 2009, por ende është i pamjaftueshëm kur marrim parasysh kostot shtesë që shoqërohen me pozitat e reja të krijuara. Kuvendi aprovoi 16 pozita të reja me buxhetin në nëntor 2009. Me anë të ligjit për ndarjet buxhetore për vitin 2010 u miratuan edhe 10 pozita të reja. Këto 26 auditorë u punësuan në fillim të vitit 2010.


Buxheti i ZAP-it për vitin 2010 është përgatitur dhe aprovuar në bazë të një marrëveshje mes ZAP-it, Ministrisë së Administratës Publike, dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, e datës 15/07.2009. Kjo marrëveshje parashikon që ZAP do të lëvizë nga ndërtesa jo më vonë se 15/12/2009 dhe do të zhvendoset në zyrat e Administratës Tatimore. Kjo gjë nuk ka ndodhur dhe ZAP tani është e detyruar të vazhdojë të paguajë qiranë shpenzimet e tjera përcjellëse. Si rrjedhojë, ZAP-i shpenzon para për qira të cilat ishin planifikuar për të paguar shpenzimet operative. Për të mbuluar shpenzimet e bëra, gjatë procesit të rishikimit të buxhetit u nda një buxhet shtesë prej €10,000.

Tabela 4 Buxheti i ZAP-it (në Euro 000)

Raporti i buxhetit	Buxheti fillestar	Buxheti i rishikuar	Buxheti i shpenzuar	%
<b>2010</b>				
Buxheti i përgjithshëm	1,359	1,571	1,547	98,5%
Paga dhe mëditje	797	816	808	99,0%
Mallra dhe shërbime	539	715	707	98.9%
Shërbime komunale	23	40	32	81.2%
<b>2009</b>				
Buxheti i përgjithshëm	1,107	1,290	1,146	88.9%
Paga dhe mëditje	523	666	585	87.9%
Mallra dhe shërbime	551	591	535	90.5%
Shërbime komunale	33	33	26	79.5%
<b>2008</b>				
Buxheti i përgjithshëm	1,204	1,204	863	71.6%
Paga dhe mëditje	360	523	406	77.5%
Mallra dhe shërbime	812	649	429	66.2%
Shërbime komunale	33	33	28	85.0%

Gjatë tre viteve 2008, 2009 dhe 2010 ne arritëm të lëvizim nga një pozicion ku vetëm 71.6% e buxhetit ishte shpenzuar, në një pozicion ku arritëm shpenzimin 98.5% të buxhetit tonë. Kjo reflekton një përmirësim të madh të aftësisë tonë për të përmbushur mision dhe mandatin si dhe për të menaxhuar buxhetin tonë.

Gjatë vitit 2010, burimet tona u përdorën si në vijim:



52% e burimeve tona financiare janë përdorur për kompensime. Në krahasim me vitet e mëparshme: kjo është një tendencë në rritje për shkak të fokusimit në rritjen e numrit të auditorëve. Në të njëjtën kohë, është sfiduese për ne që të ruajmë dhe zhvillojmë investimet në mjetet dhe shërbimet e TI-së në një nivel të mjaftueshëm për të siguruar një prodhim me efikasitet.

Përqindja e auditimeve të kontraktuara po zvogëlohet. Kryerja e punëve me stafin tonë është më pak e kushtueshme. Në të njëjtën kohë, nevojiten disa vite për të ngritur kapacitetet profesionale dhe ne duhet të përdorim punën e auditorëve të tjerë si pikë referimi në zhvillimin tonë. Shkëmbimi i përvojave është shumë i rëndësishëm për të gjitha zhvillimet profesionale.

Fakti që ne kemi marrë tashmë me qira një ndërtesë të re në qendër të qytetit, pothuajse dyfish më të madhe dhe me të njëjtin nivel të kostos se ajo e vjetra, e bën këtë pjesë të strukturës së kostos më të vogël. Pasqyrat Vjetore Financiare mundësojnë që të krahasohen ndryshimet në strukturën e kostos ose e kundërta.

### 3.2 Burime tjera buxhetore

PCN ka financuar 2 nga stafi i ZAP-it për vitin 2010. Ky është një numër më i vogël nga vitet e mëparshme.

Krahas kësaj, ne kemi marrë edhe mbështetjen nga Bashkimi Evropian përmes mekanizmit të tij të binjakëzimit. Projekti i binjakëzimit "Përkrahje për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës për të përmbushur standardet e BE-së" filloi në shtator 2009 dhe do të mbarojë në shtator 2011. Ky projekt është ndërtuar mbi projektet përkrahëse të mëparshme të BE-së dhe gjatë vitit 2010 ai e ka përforcuar auditimin e kryer nga ZAP dhe kapacitetet përkatëse.

Tabela 5 Projektet e financuara nga ZNKE/AER (në €)

Kategoria	2010	2009	2008
Përkrahje për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës (Projekt binjakëzimi i BE-së)	484,000	182,000	
Përkrahje e mëtejshme për ZAP-in <sup>1</sup>		540,000	960,000
<b>Totali</b>	<b>484,000</b>	<b>722,000</b>	<b>960,000</b>

Projekti i binjakëzimit kërkon të përmirësojë kapacitetet e ZAP-it duke vënë në zbatim veglat dhe proceset e planifikuara në platformën tonë për zhvillim dhe duke promovuar zhvillim të mëtejshëm. Ky projekt na sjell së bashku me partnerë nga Zyrat e Auditimit të Anglisë, Sllovenisë, dhe Holandës. Ekspertët nga këta institucione kanë shpërndarë mbi 70 misione ekspertize nën këtë kornizë. Këta ekspertë evropianë kanë mentoruar auditorët tanë gjatë gjashtë pilot auditimeve të rregullsisë dhe performancës në vitin e parë dhe aktualisht janë duke mentoruar edhe tetë ekipe gjatë procesit të auditimit. Kjo ka përforcuar aftësitë e auditorëve tanë për të audituar në pajtim me praktikën e mirë të BE-së.

Ekspertët partnerë të zyrës së auditimit na kanë ofruar gjithashtu ndihmë dhe udhëzues që të përforcojmë funksione të tjera të zyrës tonë, sidomos në sistemet e BNJ, zhvillimin e TI-së, ngritjen e kapaciteteve menaxhuese, si dhe ndihmë në zhvillimin e qasjes së planifikimit strategjik dhe ndarjen e mësimave të mësuara në të shkruarit e ligjit të auditimit, i përafërt me standardet e BE-së.

### 3.3 Burimet Njerëzore

Ne jemi duke operuar në një mjedis që pëson ndryshime të shpejta, dhe kurrkund nuk ndjehet kjo më shumë se në fushën e Burime Njerëzore. Ne kemi zgjeruar sasinë dhe përmirësuar cilësinë. Kemi rekrutuar një numër të lartë stafi të ri dhe kemi organizuar trajnime të duhura si për punëtorët e rinj ashtu edhe për ata ekzistues.

Një analizë për nevojat e trajnimit është kryer. Më tepër, një sistem i vlerësimit të stafit është vënë në përdorim. Ne gjithashtu kemi filluar të marrim masa për përmirësimin e modelit të certifikimit për auditorët e rregullsisë. Aktualisht, ne jemi duke u përgatitur që të fusin në përdorim sistemin e regjistrimit të kohës. Gjithsej, këto ndërhyrje do të formojnë një bazë solide për cilësi, planifikim, dhe fokusimin në rezultate.

#### Personeli

ZAP-i ka përjetuar një zgjerim domethënës në numrin e personelit viteve të fundit.

Tabela 6 Kategoritë e stafit (numrat në fund të vitit)

Kategoria	2010		2009		2008	
	Numri aktual	Pozicionet	Numri aktual	Pozicionet	Numri aktual	Pozicionet
Stafi auditor	86		61		58	
Stafi mbështetës	28		25		22	
<b>Totali</b>	<b>114</b>	<b>116<sup>2</sup></b>	<b>86</b>	<b>106<sup>3</sup></b>	<b>80</b>	<b>90</b>

1 Projekt i mëparshëm për Asistencë Teknike nga BE-ja.

2 Kjo rritje e pozitave të punës është në pajtim me Planin e Veprimit për Partneritet Evropian

3 Financimi i 106 pozitave të punës në vend të 90 u bë nga Kuvendi nga fundi i nëntorit 2009

Tabela tregon se si kemi implementuar planin e PVPE-së<sup>1</sup> në rekrutimin e stafit. Stafi shtesë mbështetës ishte një Auditor i brendshëm, një Drejtor i Burimeve Njerëzore, dhe një Zyrtar për komunikim.

Në vitin 2010, ne arritëm të rekrutojmë 31 punëtorë të rinj me synimin për të ardhur në kufirin prej 116 personash. Ky ritëm rekrutimesh do të vazhdojë dhe kemi planifikuar të punësojmë edhe tetë punëtorë të rinj në vitin 2011, duke e sjellë një total të ri prej 124 pozitash.<sup>2</sup>

### Profili i moshës së stafit

Ne jemi një zyrë e re dhe kemi këtë profil deri më dhjetor 2010.

*Tabela 7 Struktura e moshës*

Kategoritë	25 – 40	41 - 55	56 e mbi
Stafi Auditor	65	19	2
Stafi mbështetës	16	12	

76% e stafit tonë ishte nën moshën 40 vjeçare. Në vitin 2009 kjo shifër ishte 64%. Ne jemi një institucion i ri, profesional, dhe me një potencial të madh për të ardhmen. Në të njëjtën kohë, vihet re edhe mungesa e përvojës profesionale.

*Tabela 8 Rekrutimi i personelit dhe qarkullimi i personelit +*

Kategoritë/Vitet	Rekrutimi i stafit			Qarkullimi i stafit		
	2010	2009	2008	2010	2009	2008
Stafi Auditor	27	11	7	2	5	8
Stafi mbështetës	8	7	1	4	6	2
<b>Totali</b>	<b>35</b>	<b>18</b>	<b>8</b>	<b>6</b>	<b>11</b>	<b>10</b>

Numri i stafit që largohet nga Zyra po zvogëlohet. Kjo mund të jetë një indikator që stafi është i kënaqur me politikat menaxhuese, se si po drejtohet Zyra, dhe me kushtet më të mira të punës.

*Tabela 9 Profili gjinor*

Gjinia	2010	2009	2008
Femra	44	24	14
Meshkuj	70	62	66

Balanci gjinor është shumë i rëndësishëm për ne. Ne kemi vazhduar të përmirësojmë numrin e stafit femëror, duke u bazuar në meritë. Situata aktuale është se 39% e stafit janë femra. Në 2009 kjo shifër ishte 28%. Promovimi i stafit femëror në pozita të larta është një hap tjetër i rëndësishëm për tu marrë.

1 Plani i Veprimit për Partneritet Evropian

2 Kohët e fundit, Kuvendi aprovoi tetë auditorë shtesë. Përveç kësaj, ne ende mbetemi mbrapa me numrër për të cilin është rënë dakord me Qeverinë dhe Bashkimin Evropian.



Tabela 10 Komunitetet

Komuniteti	2010	2009	2008
Shqiptarë	109	81	76
Serbë	4	4	3
Të tjerë	1	1	1

Ne jemi të zotuar të rekrutojmë staf nga të gjitha komunitetet e Kosovës. Shifrat më sipër tregojnë se ende kemi rrugë për të bërë. ZAP ka publikuar njoftimet për rekrutim në gazetatat serbe dhe në radiot lokale, por përpjekjet tona nuk kanë qenë mjaft të suksesshme. Tani, ne jemi duke i ridyfishuar përpjekjet tona për të sjellë një përzierje më të balancuar të komuniteteve në ZAP.

### Edukimi

Shumica e personelit është me diplomë universitare, dhe diploma më zakonisht është ajo në fushën e ekonomikut. Ne gjithashtu punësojmë të diplomuar të tjerë nga drejtësia, shkencat politike, matematika, inxhinieria etj. Pothuajse i gjithë stafi jonë mbështetës janë të diplomuar, sidoqoftë i tërë stafi auditor kanë diplomë universitare. Pas procesit të rekrutimit të këtij viti, përqindja e stafit tonë me edukim në nivelin universitar është rritur nga 86% në 91%.

### Zhvillimi profesional

Ne na nevojitet staf i trajnuar shumë mirë. Ne po investojmë kryesisht në trajnime, si brenda edhe jashtë. Ne kemi programe trajnimi profesionale, trajnime në vendin e punës, si dhe trajnime dhe mentorime të ofruara nga burime të ndryshme të jashtme.

Ne vazhdojmë të trajnojmë në Shoqatën e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (ShKÇAK), dhe në Shoqatën e Kontabilistëve dhe Auditorëve të Serbisë (SHKAS). Të dyja shoqatat kanë programet e tyre sipas ACCA (Association of Chartered Certified Accountants).

Gjendja e stafit tonë në kuadër të këtyre niveleve është si në vijim:

Tabela 11 Nivelet profesionale

Kategoria	2010	2009	2008
Auditorët e certifikuar	23	23	18
Kontabilistët e certifikuar	25	20	18
Teknik Kontabilist i certifikuar	14	10	16
Auditorë në trajnim	21	8	3
Auditorë të Performancës	3	-	-
<b>TOTALI</b>	<b>86</b>	<b>61</b>	<b>55</b>

Ekziston një numër auditorësh që punojnë si auditorë të performancës. Ata janë vendosur mirë në skemën e paraqitur më lart. Gjithashtu, ka një numër të vogël të auditorëve të performancës që nuk janë regjistruar në trajnimet e SHKÇAK. Tani jemi në fazë fillestare për të krijuar një platformë trajnimi për auditorët e performancës. Gjithsej, 72% e auditorëve tonë kanë ndonjë nga këto kualifikime.

Ne kemi bërë një zotim të fortë në trajnime. Në vitin 2010, ne kemi arritur të organizojmë më shumë se 40 trajnime dhe këto ishin në fushat e auditimit, kontabilitetit, financave, ligjit, menaxhmentit, etc. Kjo është hera e parë që ne organizojmë një program në mënyrë të pavarur. Një program hyrës për stafin tonë të ri, i cili në të njëjtën kohë përdoret për trajnim rifreskues sipas nevojës.

Gjithsej kemi kryer 1007 ditë trajnimi. Ky numër përfshin trajnimet profesionale, sesionet e trajnimit brenda zyrës, punët në grupe dhe seminare të ndryshme. Kjo paraqet diku 8000 orë trajnime, të cilat vijnë te një mesatare prej 90 orë për person në vit. Kjo është një rritje e rëndësishme në krahasim me vitin 2009.

Përveç kësaj, projekti i binjakëzimit ka shpërndarë 44 misione ekspertize duke u koncentruar kryesisht në mentorimin e ekipeve tona dhe duke ofruar asistencë në fusha të ndryshme profesionale.



### 4. FOKUSI TEK PARTNERËT DHE REZULTATET

Zhvillimi dhe ruajtja e marrëdhënieve të mira me palët tona të interesit është një nga prioritetet kryesore. Një marrëdhënie e mirë me jashtë do të thotë një reputacion i mirë, ngrenë besueshmërinë, dhe garanton integritetin tonë. Këto janë faktorët që ndikojnë në punën tonë, dhe është ndikimi ynë i cili mbështet rolin tonë si një ndërmjetës për ndryshim të dobishëm për sektorin publik në Kosova.

Historia e zhvillimit të ZAP-it mund të ndahet në dy periudha: para dhe pas 2009. Në periudhën para 2009, ne ishim të drejtuar nga udhëzues jo specifik i auditimit. Pas marsit Zyra filloi të lëvizte drejt një procesi auditimi të ndërtuar sipas normave të pranuar ndërkombëtarisht. Këto ndryshime ishin pjesë e strategjisë tonë më të gjerë për zhvillim, Platforma 1<sup>1</sup>. Rezultatet e Platformës 1 tashmë janë realizuar dhe tani kemi kaluar në fazën e dytë të zhvillimit të e planifikuar në Platformën 2.

Këto platforma për zhvillim e kanë forcuar ZAP-in si organizatë. Së pari, ne kemi rritur shumë numrin e stafit që punon në ZAP. Së dyti, ne po përpilojmë raporte më relevante dhe me kohë dhe të cilat janë shumë më të lehta për përdorim, si rrjedhim më të lexueshme dhe më të kuptueshme. Së treti, ne kemi zgjeruar mbulimin e auditimit dhe kemi rritur dukshëm numrin e raporteve të auditimit të përpiluara nga më pak se 25 në vitin 2009 në rreth 85 për sezonin aktual të auditimit. Së katërti, ne kemi zhvilluar marrëdhënien me palët tona të interesit. Bashkëpunimi ynë me Komisionin e Kuvendit për Mbikëqyrje të Financave Publike ka rezultuar me një numër seancash buxhetore ku shpenzuesit buxhetorë janë vënë para përgjegjësisë. Bashkëpunimi me median dhe shoqërinë civile është zhvilluar gjatë vitit në mënyra të ndryshme. Llogaridhënia është një shqetësim për të gjitha sektorët e shoqërisë.

Bashkëpunimi me struktura të ndryshme qeveritare dhe projekte zhvillimore ka rezultuar në modernizimin e kornizës së llogaridhënies dhe në qasje e sisteme të organizuara më mirë për ekzekutimin e buxhetit.

Gjithsej, ne kemi bërë shumë progres, por ende mbetet për tu bërë. Ne duam të ruajmë hovin për ndryshim, si brenda organizatës tonë ashtu edhe në administratën publike në tërësi. Ne duhet të vazhdojmë të ndërtojmë duke kuptuar dhe zbatuar qasjet dhe teknikat e reja. Sigurimi i cilësisë dhe efikasitetit në veprimet tona është një sfidë e pandërprerë në ofrimin e shërbimeve për qytetarët. Për të arritur këtë, ne po ndërtojmë një zyrë që do të shndërrohet në një organizatë që bazohet në njohuri, që ofron përsosmëri profesionale, duke ruajtur pavarësinë dhe komunikuar në një mënyrë të balancuar dhe të vërtetë ashtu siç janë edhe vet objektivat tona strategjike kryesore.

#### **Bashkëpunimi kombëtar**

Gjatë vitit 2010 ne krijuam dhe zhvilluam marrëdhënie me palët e interesit primare tonat, Kuvendi dhe Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike (KMFP). Një numër dëgjimesh publike janë mbajtur për të vënë shpenzuesit buxhetorë para përgjegjësisë. Plani vjetor i punës së KMFP-së u përgatit në bashkëpunim me ne. Ne duhet të zhvillojmë një marrëdhënie efektive pune bazuar mbi të kuptuarit reciprok të roleve dhe objektivave të njëri-tjetrit. Gjithashtu duhet ta vazhdojmë atë dialog dhe të përcaktojmë pritshmëritë sipas standardeve profesionale të auditimit dhe praktikës së mirë Evropiane.

1 Elementet e Planit tonë të inkorporuar për zhvillim. Ai fokusohet në Kornizën e Menaxhimit të Cilësisë, Strukturën Organizative, Manualin e Auditimit të Rregullsisë, Udhëzuesin e Auditimit të Performancës, Kodin e Mirësjelljes, dhe proceset për raportimin tonë rreth kryerjes së auditimit. Platforma 2 harton përvojat e fituara dhe siguron mekanizmat e brendshme duke nxitur krijimin e cilësisë së qëndrueshme.



*Takim me Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike në Kuvend*

Me tutje, ne duhet të ruajmë bashkëpunimin e mirë me Ministrinë e Financave dhe entitetet e tjera të audituara për sa i përket zhvillimit të sistemeve dhe proceseve të qëndrueshme të menaxhimit të financave publike si dhe rregullimeve të besueshme për raportim.


Bashkëpunimi ynë me median dhe shoqërinë civile është forcuar dhe zhvilluar në mënyrë efektive gjatë vitit. Media luan një rol të rëndësishëm në analizimin dhe shpërndarjen e informacionit në lidhje me ekzekutimin e buxhetit funksionimin e administratës publike. Ne mezi presim që të ngrejmë marrëdhënien tonë me median në mënyrë që të rrisim transparencën dhe ti ofrojmë publik informacion të qartë dhe të relevant.

Kuvendi, Qeveria, dhe Gjyqësori janë partnerë me përgjegjësi të veçanta në sigurimin e “kontrolleve dhe bilanceve” në shtylla të ndryshme të administratës publike. Një kornizë e zhvilluar komunikimi e bazuar mbi një mirëkuptim reciprok të roleve përkatëse të këtyre entiteteve do të hap rrugën për një shërbim publik më të mirë.

Më tutje, gjatë vitit ne kemi pasur një bashkëpunim të mirë me shoqërinë profesionale të auditimit, OJQ, firma private të auditimit, ofrues kombëtar të trajnimeve, median, donatorët, dhe gjyqësorin me qëllimin për të promovuar praktikat e mira të menaxhimit financiar, për të zhvilluar profesionin tonë, dhe për të forcuar transparencën dhe llogaridhënien.

### **Bashkëpunimi ndërkombëtar**

Siç u përmend më lart, ne po punojmë ngushtë me partnerët tanë nga Zyrat e Auditimit të Anglisë, Sllovenisë, dhe Holandës përmes një projekti binjakëzimi të financuar nga BE. Ky ka qenë një projekt shumë i suksesshëm dhe ka punuar me ZAP për të zbatuar Platformën 1 dhe aktualisht janë duke u arritur objektivat e Platformës 2.



Përveç projektit të binjakëzimit, këtë pranverë ne kemi krijuar një marrëveshje bashkëpunimi me Zyrën Kombëtare Suedeze të Auditimit. Ky projekt do të na ndihmojë neve, në një afat të shkurtër (1 mars deri në 31 gusht 2011) që të ndërtojmë kapacitet tona në fushën e auditimit të performancës si dhe në futjen në përdorim të një sistemi të ri të regjistrimit të kohës, i cili do të na ndihmojë që ta ndajmë burimet tona me staf në mënyrë më efektive. Nga fillimi i sezonit tjetër, parashikohet që ky projekt të na ndihmojë në zbatimin e Platformës 2.

Ne jemi gjithashtu në proces për të bërë një marrëveshje bashkëpunimi me USAID në lidhje me auditimin e komunave.

ZAP nuk arriti të bashkohet me INTOSAI-in apo EUROSAI-in sepse Kosova ende nuk është një anëtare e Kombeve të Bashkuara. Ne as nuk jemi ftuar në Rrjetin e Institucioneve Supreme të Auditimit nga vendet kandidatë apo kandidatë potenciale të BE-së dhe në Gjykatën Evropiane të Auditimit. Megjithatë, ne kemi arritur të marrim pjesë në konferenca dhe seminare të ndryshme në vendet rajonale dhe evropiane, por vetëm deri në një farë niveli. Mundësia për të ndarë përvojat me kolegë nga vende të tjera është thelbësore për të gjithë zhvillimin.

### 5. ARRITJET STRATEGJIKE

Objektivat specifike të auditimit janë përdorimi i duhur dhe efektiv i fondeve publike; zhvillimi i menaxhimit të shëndoshë të parasë publike; kryerja si duhet e aktiviteteve administrative; dhe komunikimi i informacionit tek autoritetet publike dhe publiku i gjerë përmes publikimit të raporteve objektive. Zbatimi i kësaj konsiderohet si e nevojshme për stabilitetin e dhe zhvillimin e shtetit në pajtim me objektivat e INTOSAI-it (Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit -ONISA).

Ne jemi të dedikuar për tu bërë një Institucion Suprem i Auditimit (ISA) që funksionon mirë. Disa nga atributet për këtë janë si në vijim:

- Përmbushja e rolit tonë si një *shtyllë e rëndësishme e sistemit të llogaridhënies* në një demokraci moderne – një vetëdijesim më i lartë ideor për rolin dhe detyrat tona. Roli si një *verifikues i pavarur i informacionit ekonomik dhe të performancës, si dhe statusi nga ligjshmëria dhe pikëpamja e 3E-ve (ekonomi, efikasitet, efektivitet)* në zinxhirin komandues: Zyrtar Kryesor Administrativ, ministri, Qeveri, dhe Kuvend;
- *Marrëdhënie të mira pune me kuvendin dhe Qeverinë, Median dhe Publikun;*
- *Të vepruarit në balancë me aktorët e tjerë të Sistemit të Menaxhimit të Financave Publike: optimizimi i të dobive të të gjithë Sistemit të Menaxhimit të Financave Publike;*
- Promovimi i standardeve të larta të transparencës, llogaridhënies, dhe integritetit në menaxhimin financiar dhe performancën e administratës publike;
- Përmbushja sa më mirë e *mandatit dhe fushëveprimit tonë për auditim në një mënyrë të balancuar, të qëndrueshme, dhe afatgjatë;*
- Respektimi i *standardeve të auditimit të njohura ndërkombëtarisht;*
- Të kuptohemi nga palët tona të interesit si një *burim i pavarur, objektiv, dhe i besueshëm i informacionit;*
- *Shpërndarja me kohë dhe me cilësi të lartë e raporteve të auditimit – duke i shtuar vlerën palëve të interesit;*
- Zhvillimi i mirë i *procedurave përcjellëse* për veprimet që duhet të merren mbi të gjeturat dhe rekomandimet e auditimit nga palët e interesuara – entitetet e audituara, Qeveria, dhe Kuvendi;
- Përdorimi i një qasje moderne të Menaxhimit total të cilësisë mbi *Menaxhimin e Cilësisë së auditimit;* dhe
- *Një organizatë që orientohet tek grupe të tjera që i interesojnë apo ku dëshiron të jetë më e përfshirë – gjithmonë në kërkim të përmirësimeve dhe përdorimit efikas të burimeve.*

Do të duhet kohë për transformimin e ZAP-it në një Institucion Suprem i Auditimit (ISA) që funksionon mirë. Rezultatet e arritura deri në (prill 2011) janë inkurajuese. Rruga që ne kemi marrë nuk është thjesht një çështje e aftësive teknike. Ajo ka të bëjë me të kuptuarit e rolit të një ISA-je në një shoqëri demokratike dhe me zbatimin e strategjisë tonë afatgjatë. Për më tepër, është një çështje e përvetësimit të kulturës sipas vlerave tona: llogaridhënia, transparenca, sinqeriteti, përgjegjshmëria, dhe bërja e ndryshimit që praktikisht duhet të zbatohet. Një mirëkuptim që duhet të ndahet mes palëve tona të interesit dhe nesh.

## 6. LLOGARIDHËNJA E ZAP-it

### Sigurimi i integritetit

Përmes kësaj, garantoj se informacioni në Raportin Vjetor të Performancës, përfshirë edhe pasqyrat financiare, janë të sakta, të besueshme, dhe objektive.



Lars Lage Olofsson, Auditor General

### Deklarata e Transparencës

Përmes kësaj, garantoj se puna jonë gjatë vitit 2010 është kryer në pajtim me Statutin e Shërbimit Civil dhe Kodin e mirësjelljes së ZAP-it:



Qerkin Morina, Zëvendës Auditor i Përgjithshëm;



Ibrahim Gjylderren, Zëvendës Auditor i Përgjithshëm;



Fatmir Uka, Udhëheqës i Administratës.

## **Annex**

### **Pasqyrat Vjetore Financiare të ZAP-it për vitin 2010**



## Raporti Vjetor i Performancës

### Neni 9.

#### Pasqyra e Pranimeve dhe pagesave të Parave të gatshme

		2010	2009	2008
		Llogaria e Vetme e Thesarit	Llogaria e Vetme e Thesarit	Llogaria e Vetme e Thesarit
		BK	BKK	BKK
Shënim		€ '000	€ '000	€ '000
<b>PRANIMET</b>				
Ndarjet nga Fondi i Përgjithshëm	1	1.547	1.146	821
<b>Totali i Pranimeve</b>		<b>1.547</b>	<b>1.146</b>	<b>821</b>
<b>PAGESAT</b>				
Operacionet				
Pagat dhe Mëditjet		808	585	406
Mallrat dhe Shërbimet		707	535	429
Shërbimet Publike		32	26	28
<b>Totali i Pagesave</b>		<b>1.547</b>	<b>1.146</b>	<b>863</b>
Shënim				

1) Totali i pranimeve është më i lartë se totali i shpenzimeve për 1,782.15€. Këto mjete janë mjetet e kthyer nga avanset në llogarinë e NLB dhe do të krijohen si shpenzime në vitin 2011.

### Neni 10.

#### Raporti i ekzekutimit të buxhetit

Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore aktuale për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010

	2010				2009	2008
	Buxheti fillestar A	Buxheti Final B	Aktuali C	Ndryshimi D=C-B	Realizimi E	Realizimi F
	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000
<b>Daljet e parasë së gatshme nga llogaritë e thesarit</b>						
Pagat dhe mëditjet	797	816	808	-8	585	406
Mallrat dhe Shërbimet	539	715	707	-8	535	429
Shërbimet publike	23	40	32	-7	26	28

**Neni 11.**

**Shpalosja e shënimeve**

**Shënimi 1**

Auditori i Përgjithshëm caktohet nga PCN-ja për një periudhë pesë vjeçare. Viti 2010 është viti i tij i dytë në detyrë. Auditori i Përgjithshëm është përgjegjës për drejtimin në përgjithësi të ZAP-it dhe cakton strategjinë zhvillimore të Zyrës. Strategjia e Përbashkët Zhvillimore (SPZH) e ZAP-it përcakton misionin e ZAP-it si dhe pasqyron një vizion të qartë për këtë periudhë.

Objektivi i misionit strategjik i ZAP-it, duke u bazuar mbi auditimin cilësor dhe në kohë të sektorit publik, është që të kontribuojë në ndërtimin e një menaxhimi të shëndoshë financiar në administratën publike, i karakterizuar nga llogaridhënia e fortë menaxheriale për përdorim transparent të burimeve publike dhe rezultatet e arritura nga politikat. Auditori i Përgjithshëm synon të ndërtojë një Zyrë Kombëtare të Auditimit të Kosovës, plotësisht funksionale dhe e gatshme për tu radhitur mes Institucioneve të Larta të Auditimit të Evropës. Një organizatë e tillë do të drejtohet tërësisht nga kosovarët dhe do të jetë plotësisht e qëndrueshme. Themelet e sigurta mbi të cilat ky mision dhe vizion bazohen janë *Acquis Communautaire* dhe PVPE 2008.

Baza ligjore gjendet në Kushtetutë, Ligjin për ZAP-in, dhe kornizën e përgjithshme ligjore që ka të bëjë me menaxhimin e financave publike dhe administratën.

Pasqyrat Vjetore Financiare të vitit 2010 përgatiten sipas SNKSP – Parime të bazuara në parane e gatshme dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 16/2010 për Raportimin vjetor të organizatave buxhetore.

**Shënimi2.**

**Ndarjet e fondit të përgjithshëm**

	2010	2009	2008
Klasifikimi ekonomik	BK	BK	BK
shënim	€ '000	€ '000	€ '000
Pagat dhe mëditjet	808	585	406
Mallrat dhe Shërbimet	707	535	429
Shërbimet Publike	32	26	28
<b>Totali</b>	<b>1,547</b>	<b>1,146</b>	<b>863</b>
<b>Totali i pagesave i bërë nga BK nëpërmes të LIVTh</b>	<b>1,359</b>	<b>1,571</b>	<b>1,547</b>
	<b>-23</b>	<b>1,146</b>	<b>863</b>

**Shënimi5.**

**Pagat dhe mëditjet**

		2010	2009	2008
		BK	BK	BK
Përshkrimi	shënim	€ '000	€ '000	€ '000
<b>Pagesat nga BK</b>				
Neto pagat	5,1	687	498	347
Tatimi ne të hyrat personale		44	31	20
Kontributit pensional nga punëdhënësi		38	28	19
Kontributit pensional nga i punësuari		38	28	19
<b>Totali</b>		<b>808</b>	<b>585</b>	<b>406</b>

Shënim

5.1) Pagat neto përfshijnë shujtat në shumë prej 66€ në muaj për person. Bazë për kalkulim është marrë numri i stafit prej 116 për vitin 2010, 85 për 2009, dhe 80 për 2008.

## Raporti Vjetor i Performancës

### **Shënimi 6.**

#### **Mallrat dhe shërbimet**

Përshkrimi	Shënim	2010	2009	2008
		BK	BK	BK
		€ '000	€ '000	€ '000
<b>Pagesat nga BK</b>				
Shpenzimet e udhëtimit brenda vendit		9	1	
Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit		17	14	34
Internet		2	1	0
Shpenzimet tjera telefonike Vala900		23	18	17
Shërbimet e arsimit dhe trajnimit	6,1	25	16	15
Auditime te jasht.-auditimi i komunave	6,2	235	118	54
shërbime shtypje -jo marketing		1	0	
Shërbime kontraktuese tjera		11	17	8
Shërbime teknike		6	1	2
Mobilet dhe pajisjet(më pak se 1000)		17	22	
Telefona (më pak se 1000€)		10	1	1
Kompjuterë (më pak se 1000€)		30	18	
Harduer për TI<1000		1	2	
Makina fotokopjuese<1000			5	
Pajisje tjera <1000€		20	17	28
Pajisje tjera (1000-5000)				11
Furnizime për zyre		22	21	4
Furnizime ushqim dhe pije		1	2	0
Furnizime pastrimi		2	4	6
Furnizime veshmbathje		0	10	2
Akomodimi		6		0
Vaj për ngrohje	6,3	11	2	4
Derivate për gjenerator		1	1	7
Karburant për vetura		8	8	9
Regjistrimi i automjeteve	6,4	0	7	9
Sigurimi i automjeteve		6		
Taksa komunale		1		
Sigurimi i ndërtesave dhe tjera		15	14	15
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve		4	6	5
Mirëmbajtja e ndërtesave		14	10	7
Mirëmbajtja e tekn.informative		15	8	0
Mirëmbajtja e mobileve dhe pajisjeve		0	1	
Qiraja për ndërtesa		168	168	168
Qiraja-përdorime tjera të hapësirës		0	0	
Reklamat dhe konkurset		2	0	9
Botimet e publikimeve		8	10	8
Informimi publik		9	10	
Drekat zyrtare		4	2	4
<b>Totali</b>		<b>707</b>	<b>535</b>	<b>429</b>

#### Shënim

6.1) Shërbimet e arsimit dhe trajnimit janë pagesat që i bëhen SHKQAK për trajnime për auditorë

6.2) Shërbime të ndryshme intelektuale janë përdorur për pagesat e bëra për kontraktimin e kompanive që kryejnë auditimin ligjor të PVF-ve të komunave. Shuma prej €235.000 në vete përfshin shumën: 36,500€ ( kisti i trete ) për auditimin final të PVF-ve 2008 për 20 Komuna, shumën 142,000€ për auditimin final të PVF-ve 2009 për 29 Komuna dhe shumën prej 56,600€ për auditimin e parakohshëm për vitin 2010 të 23 komunave.

6.3) Sistemi i ngrohjes në objektin e ri kërkon furnizim me naftë. Ne objektin e vjetër gasi për nxehje ka kushtuar më pak.

6.4) Në vitin 2010, regjistrimi i automjeteve ,sigurimi i automjeteve dhe taksa komunale janë të ndara nëpër kode të veçanta

**Shënimi 7**  
**Shërbimet komunale**

Përshkrimi	shënim	2010	2009	2008
		BK	BK	BK
		€ '000	€ '000	€ '000
rryma		13	10	11
uji		1	1	1
mbeturinat		2	2	2
PTK-fikse		16	13	14
<b>Totali</b>		<b>32</b>	<b>26</b>	<b>28</b>

**Neni 13.**

**Shënimi 25 Pasqyra e faturave (obligimeve) të papaguara**

**a. Të dhënat nga SIMFK**

Nr urdhërblerja	Shuma urdhërblerja	Kodi ekon.	Përshkrimi	Furnitor	Shuma e paguar	mallrat pranuar	2010 shuma
27996	970	14010	autolarje	VALI			195
27996	970	14010		VALI			240
27996	970	14010		VALI			535
<b>Totali</b>							<b>970</b>

**b. Detyrime tjera**

2010

Data e pranimit te faturës	Numri i Faturës	Kodi ekon.	Afati i pagesës	Furnitor	Përshkrim	Arsyeja mos pageses	shuma
26.11.2010	6030157/189	13320	27.12.2010	Vala	dhjetor	Fature e vonuar	35
25.01.2011	6030157/193	13320	27.01.2011	Vala	dhjetor	Fature e vonuar	26
10.01.2011	28004574/191	13320	27.12.2010	Vala	dhjetor	Fature e vonuar	39
12.12.2010	28004574/193	13320	27.01.2011	Vala	dhjetor	Fature e vonuar	6
30.12.2010	2010-12-30	14050	10.01.2011	Grelda	servisimi i gjeneratorit	Fature e vonuar	328
28.12.2010	Z-13/10	14310	10.01.2011	DEA	dhjetor	Fature e vonuar	168
10.01.2011	4640/10	13780	10.01.2011	Petroll	nafta-vetura	Fature e vonuar	796
10.01.2011	A511/01/33	13310	10.01.2011	Kujtesa	dhjetor	Fature e vonuar	464
14.01.2011	42547802011	13250	25.01.2011	PTK	dhjetor	Fature e vonuar	1.291
08.01.2011	12/2010/R	13210	23.01.2011	KEK	dhjetor	Fature e vonuar	1.621
14.01.2011	12166/10	14210	14.01.2011	K.Sot	Publikime	Fature e vonuar	186
10.01.2010	1889	14010	10.01.2011	VALI	dhjetor	Fature e vonuar	36
22.01.2011	28004574/191	13320	27.01.2011	Vala	dhjetor	Fature e vonuar	6
<b>Totali</b>							<b>5.002</b>

## Raporti Vjetor i Performancës

### Neni 15.

#### Shënimi 27. Përmbledhje e pasurive jo-financiare ne posedim të organizatës buxhetore

Klasifikimi i pasurive		Vlera neto e 2010	2010	2009	2008
shënim		€ '000	€ '000	€ '000	€ '000
<b><u>Pajisjet mbi 1000€</u></b>					
veturat	27.1	68	159	193	193
pajisje të TI	27.2	13	200	330	287
pajisje tjera	27.3	25	79	69	65
	<b>27.4</b>	<b>106</b>	<b>437</b>	<b>592</b>	<b>546</b>
<b><u>Pajisjet me vlerë më të vogël se 1000€</u></b>					
<b>Kostoja historike</b>					
pajisje të TI	27.5	7	7	16	251
kompjuterë		149	149	119	
makina fotokopjuese		26	26	26	
softuer për auditor		15	15	15	
mobile		74	74	63	
pajisje tjera	27.6	47	47	29	
	<b>27.7</b>	<b>319</b>	<b>319</b>	<b>270</b>	<b>251</b>
<b>Totali</b>	<b>27.8</b>	<b>425</b>	<b>756</b>	<b>862</b>	<b>797</b>

### Neni 16. Shënimi 30: Detyrimet kontingjente

Natyra e detyrimeve kontingjente		2010	2009	2008
Shënim		€ '000	€ '000	€ '000
qiraja				
<b>Totali</b>	<b>30,1</b>	<b>10</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

#### Shënim

27.1) Vlerat e prezantuara për vitin 2008,2009 dhe 2010 kanë të bëjnë me koston historike. Dy nga nëntë veturat janë zhvlerësuar gjatë 2010(në shumë prej 0€)dhe janë tjetërsuar në MAP sipas Memorandumit të Mirëkuptimit Nr. 346/2010. Ndërsa shtatë veturat tjera janë prezantuar në vlerën neto.

27.2) Pajisjet e TI me vlerë më të madhe se 1,000€ -të zhvlerësuar( me vlerë monetare €0) janë tjetërsuar tek MAP në baze të Memorandumit të Mirëkuptimit nr. 340/2010

27.3) Pajisje tjera me vlerë më të madhe se 1,000€ janë: file kabinete për arkiva, printerë,pajisje zërimi,shkatërrues letre..

27.4 Vlera e pajisjeve mbi 1,000€ pas zhvlerësimit nga MEF-i

27.5) Pajisje të TI nën 1000€ ,me vlerë monetare të blerjes( të pa zhvlerësuar)janë zvogëluar për 10.000€. Janë dorëzua ne MAP . Marrëveshja për këtë ka nr .340/2010

27.6)Në pajisje tjera nen 1,000€ janë te përfshirë:telefona,çanta,llamba tavoline,pajisje për gjenerator,TV, dispanzera të ujit,mikrovala

27.7) Vlera e pasurisë nën 1,000€ , ende e pa zhvlerësuar. Zhvlerësimi do të kryhet gjatë vitit 2011

27.8)Vlera totale e pasurive, ku të gjitha asetet me vlerë mbi 1000€ janë zhvlerësuar ndërsa ato me vlerë më të vogël se 1000€ nuk janë zhvlerësuar.

30.1) Shuma e prezantuar është një përlllogaritje e kompensimit eventual për riparime të ish-zyrës sonë.

Qiradhënësi i mëhershëm – me sa jemi në dijeni - ka paraqitur rastin në Gjykatë

**Neni 17.**

**Raporte plotësuese**

**Shënimi 11. Harmonizimi i ndarjeve fillestare dhe finale te buxhetit**

Përshtatjet e Autorizuara nga LMFP

Kategoria e ndarjes	shënim	Buxheti fillestar (ligji i buxhetit)	Ndryshimi sipas nenit 29,Ligji nr.03/L-048	Ndryshimet për te hyrat vetanake	Ndarjet finale te buxhetit SIMFK	Ndryshimet e buxhetit fillestar
		€ '000 a	€ '000 b	€ '000 e	€ '000 f	% (f-a)/f
<b>Hyrjet</b>						
Garanti qeveritar	11,1	1.359	1.571		1.571	
Të hyrat vetanake	11,2			3		0
		<b>1.359</b>	<b>1.571</b>	<b>3</b>	<b>1.571</b>	<b>13.5</b>
<b>Daljet(buxheti)</b>						
Pagat dhe mëditjet	11,3	797	816		816	2.3
Mallrat dhe shërbimet		539	715		715	24.6
Shërbimet publike		23	40		40	42.5
<b>Totali</b>		<b>1.359</b>	<b>1.571</b>	<b>0</b>	<b>1.571</b>	<b>13.5</b>

Shënim

11.1)Buxheti fillestar dhe buxheti pas rishikimit:

11.2)ZAP ka hyrë në një kontratë tri vjeçare për auditimin vjetor të projektit Danida. Tarifat e paguara për auditimin 2009 ende gjinden në llogarinë kryesore të Thesarit.

11.3)Për shkak të rritjes së stafit me rishikim të buxhetit , ZAP-it i është aprovua buxhet shtesë:

- Paga dhe mëditje në shumë prej	18.639
- Shpenzimet shtesë nga mallrat dhe shërbimet	6.361
- Qiraja me shpenzimet përcjellëse	168.000
- Shpenzimet komunale	17.000
<b>Totali</b>	<b><u>210.000</u></b>

## Raporti Vjetor i Performancës

### Raport i ekzekutimit të Buxhetit

€ '000

	Buxheti fillestar	Buxheti Përfundimtar	Pagesat	Progresi	Progresi
Përshkrimi	Ligji nr. 03/L-105	SIMFK		në, %	në, %
	b	c	d	e=d/b	f=d/c
<b>Pagesat nga Grandi i Përgjithshëm</b>	<b>1.359</b>	<b>1.571</b>	<b>1.547</b>	<b>114%</b>	<b>99%</b>
Rrogat dhe Pagat	797	816	808	101%	99,%
Mallrat dhe Shërbimet	539	715	707	13%	99%
Shpenzimet Komunale	23	40	32	143%	81%

### Raport i Pagesave sipas Programeve

€ '000

Përshkrimi	Auditor	IT	Administratë	Gjithsej Pagesat
	b	c	d	f=b+c+d+e .
<b>Pagesat nga Grandi i Përgjithshëm</b>	<b>641</b>	<b>29</b>	<b>877</b>	<b>1.547</b>
Rrogat dhe Pagat	641	29	138	808
Mallrat dhe Shërbimet			707	707
Shpenzimet Komunale			32	32

### Raport i Pranimeve sipas Programeve

€ '000

Përshkrimi	Kodi ekonomik	Auditor	IT	Administratë	Gjithsej Pranimet
		b	c	d	f=b+c+d+e+
<b>Pagesat nga Grandi i Përgjithshëm</b>		<b>641</b>	<b>29</b>	<b>877</b>	<b>1.547</b>
Rrogat dhe Pagat	11	641	29	138	808
Mallrat dhe Shërbimet	13	-	-	707	707
Shpenzimet Komunale	14	-	-	32	32

### Pagesat nga Fondi i Përgjithshëm

€ '000

Klasifikimi Funkcional	Klasifikimi ekonomik			
	Pagat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Totali
Shërbimet e përgjithshme	808	707	32	<b>1.547</b>
<b>TOTALI</b>	<b>808</b>	<b>707</b>	<b>32</b>	<b>1.547</b>

**Neni 12.**

**Numri i punëtorëve**

Departamenti	Nr i punëtorëve ne Ligjin e buxhetit 03/L-105	Nr. Aktual i punëtorëve në fillim të vitit 2010	Nr. Aktual i punëtorëve në fund të vitit 2010
<b>TOTALI</b>	<b>116</b>	<b>86</b>	<b>117</b>
Departamenti i Auditoreve	89	61	91
Departamenti i Administratës	23	21	23
Departamenti i Teknologjise informative	4	4	3

Shënim

Për shkak të pushimit të lehonisë, janë angazhuar auditorë zëvendësues për një periudhë të caktuar kohore duke na mundësuar kështu që të kryejmë shërbimet tona në mënyrë të mjaftueshme. Aktualisht, në këtë mënyrë janë angazhuar tre persona.

Edhe dy poste janë të lira për sa i përket 31.12.2010

Auditori i Përgjithshëm dhe Shefi i Kabinetit nuk janë të përfshirë për shkak se ata paguhen nga ZCN-ja.

**Neni 18.**

**Ligji nr.03/L-221**

**Raporti për veprimet e ndërmarra dhe të propozuara për gjetjet dhe rekomandimet e Auditorit të pavarur**

Sipas Ligjit për ZAP, pasqyrat tona financiare do të Auditohen për çdo vit nga një kompani ndërkombëtarisht e pranuar e emëruar nga Kuvendi. PVF-të e ZAP për vitin 2009 janë audituar nga ana e Grant Thornton e cila ka dhënë opinion të pa kualifikuar. Në letrën e Menaxhmentit janë dhënë rekomandime për disa mangësi shumë të vogla sidomos në fushën e prokurimit. ZAP ka marrë masa për të minimizuar riskun për gabime të tilla në të ardhmen.